



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE

“AXHENDA DIXHITALE E SHQIPËRISË 2015-2020:

Raport Monitorimi

DHJETOR, 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

## Tabela e Përmbajtjes

*A. Hyrje*

*B. Vlerësim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë*

*a. Ecuria e takimeve të Grupit në Tematik Dixhitalizimi dhe-Qeverisja*

*C. Progresi i zbatimit të projekteve në kuadër të secilit Prioritet*

*a. Prioriteti I: Politika për zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe ofrimi i shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset*

*b. Prioriteti II: Politika për zhvillimin e infrastrukturës TIK dhe komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët (shëndetësi, arsim, mjedis, turizëm, kulturë, energji, transport etj)*

*c. Prioriteti III: Krijimi i Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI)*

*D. Konkluzione dhe rekomandime*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

### LISTA E AKRONIMEVE

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHTRR	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor
DZHM	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, Kryeministria
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
GMIP	Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
INSTAT	Instituti i Statistikave
KDS	Komitet Drejtues Sektorial
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
SPI	Sistemit të Planifikimit të Integruar



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

SHKP Shërbimi Kombëtar i Punësimit

ZRPP Zyra e Rregjistrimit e Pasurive të Paluajtëshme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

## A. Hyrje

Strategjia e Axfordës Dixhitale në Shqipëri një ndër prioritetet e Qeverisë ka luajtur rolin e një instrumenti kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit në vend.

Strategjia Ndërsektoriale “*Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020*”, u miratua me vendimin nr. 284 datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave. Kjo strategji e hartuar në përputhje me Axfordën Europiane 2020 dhe Strategjinë Rajonale SEE-2020, synon një drejtim të koordinuar dhe efikas të zhvillimeve në axhendën dixhitale me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarin dhe përmirësimin e jetesës.

Prioritetet madhore të kësaj strategjie janë: *përmirësimi i infrastrukturës kombëtare të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; zhvillimi i qeverisjes elektronike si dhe krijimi i Kadastrës Shumëqëllimshme*. Këto janë prioritete afatgjata, të parashikuara dhe në SKZHI dhe të shtrira në kohë, në periudhën 2015-2020.

Në fazën e parë të implementimit të AD, 2015–2017 (objektivat afatmesme), përpjekjet janë përqëndruar në implementimin e projekteve për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës TIK si dhe në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe procedurave për hartimin e politikave që rrjedhin nga këto ndryshime.

Faza e dytë, që përfshin periudhën 2018 - 2020 (objektivat afatgjata), synon konsolidimin e arritjeve të realizuara në fazën e parë të zbatimit të strategjisë, duke përfshirë më tej aktivitete të reja në fushat kryesore të reformës administrative.

Për monitorimin e implementimit të Strategjisë janë vendosur indikatorë të lidhur me shkallën e përdorimit të TIK dhe e-qeverisjes nga individët dhe bizneset. Pjesë e këtyre indikatorëve janë dhe treguesit për aftësi TIK, TIK në arsim, e-shëndetësia, të cilët janë pjesërisht dhe planifikuar për t’u plotësuar gjatë viteve.

Për të reflektuar zhvillimet e fushës është shkuar drejt një përfaqje sektoriale nëpërmjet krijimit të Grupit të menaxhimit të Integruar të Politikave për Inovacionin dhe Mirëqeverisjen në ndihmë të të cilit është edhe ngritja e grupit tematik për Dixhitalizimin dhe e-qeverisjen.

Në mbështetje të VKM-së NR. 673 Datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, është vijuar me ndjekjen e progres raportit bazuar në raportimet e bëra nga institucionet zbatuese gjatë viteve 2019-2020. Raporti vjetor i monitorimit të Strategjisë Axfordë Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020 ka për qëllim të prezantojë progresin e përgjithshëm të zbatimit të Strategjisë bazuar në shtyllat kryesore të saj.

Gjithashtu kjo analizë shoqërohet me dhënien e konkluzioneve të gjetjeve dhe rekomandime që i paraprijnë procesit të rishikimit të planit të veprimit për fazën e dytë të implementimit të saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

### *B. Vlerësim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë*

Në mbështetje të VKM-së NR. 673 Datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" i ndryshuar, VKM-së Nr. 284 datë 01.04.2015 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale "Akhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020", Urdhrit të Kryeministrit Nr. 157 datë 22.10.2018 "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar" si dhe Urdhërit Nr. 841 datë 21.12.2018 për analizimin e plan veprimit të strategjisë Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020 u ngrit Grupi i Punës për analizimin dhe përditësimin e situatës aktuale të realizimit të aktiviteteve dhe objektivave të vendosura në Plan Veprim duke u koordinuar me institucionet e përfshira për sa i takon:

- Projekteve në fushën TIK të parashikuar në plan veprim nën përgjegjësinë e AKSHI-t, të cilët janë realizuar dhe ato të pa realizuara;
- Projekteve në fushën TIK të parashikuar në plan veprim nën përgjegjësinë e institucioneve të tjera, të cilët janë realizuar dhe ato të pa realizuara;
- Evidentimin e finalizimit të procesit të kalimit kapital lidhur me sistemet/infrastrukturën TIK, për projektet në fushën TIK të parashikuar në plan veprim por ende të përealizuara nga institucionet e tjera

Grupi i punës gjatë periudhës mars 2019-dhjetor 2020 pati jo vetëm rol koordinues në sigurimin e bashkëveprimit midis anëtarëve të Grupit Tematik por gjithashtu, edhe rol monitorues lidhur me raportimin e saktë të informacioneve në plan veprim duke përfshirë këtu komunikimin në formë elektronike me ta por edhe takimet e shpeshta si me departamentin e zhvillimit dhe mirëqeverisjes në Kryeministri ashtu dhe me IT e AKSHI-t të atashuara pranë institucioneve në vend.

Muaji i fundit përfshiu konsolidimin e informacionit të mbledhur në një raport të vetëm lidhur me projektet e reja për tu përfshirë në planin e ri të veprimit gjithashtu dhe plotësimin e saktësimin e informacionit në aktivitetet e strategjisë axhenda dixhitale e Shqipërisë 2015-2020.

Nuk duhet lënë pa përmendur vështirësia e hasur në plotësimin e informacionit duke qenë se ka patur një sërë ndryshimesh në strukturat e institucioneve dhe stafi aktual nuk ka mundur të pajiset me materialin e duhur për plotësim. Për sa më lart kanë vijuar takimet me përfaqësuesit e grupit tematik për të siguruar që informacioni të plotësohet i saktë dhe me një format standard.

#### *a. Ecuria e takimeve të Grupit nën Tematik Dixhitalizimi dhe-Qeverisja*

Grupi Tematik Dixhitalizimi dhe e-Qeversja u takua online në korrik 2020 nën respektimin e rreptë të masave anti-COVID, me qëllim sigurimin, koordinimin, dialogimin, monitorim sistematik dhe vlerësim të progresit të reformave në nënsektorë. Në këtë takim u paraqit një vështrim i përgjithshëm i punës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

duke prezantuar kështu platformat elektronike të ngritura deri më tani, punën e muajve të fundit dhe duke përmendur shkurtimisht projektet e reja në implementim.

Vlerësimi i realizimit të objektivave të strategjisë AD 2015-2020, është bërë duke ndjekur në mënyrë periodike realizimin e planit të aktiviteve të parashikuara për periudhën 2018-2020 si dhe ecurinë e indikatorëve kryesorë të monitorimit.

Gjatë periudhës mars 2019 – dhjetor 2020 pati jo vetëm rol koordinues në sigurimin e bashkëveprimit midis anëtarëve të Grupit Tematik por gjithashtu, edhe rol monitorues lidhur me raportimin e saktë të informacioneve në plan veprim duke përfshirë këtu komunikimin në formë elektronike me ta por edhe takimet e shpeshta si me departamentin e zhvillimit dhe mirëqeverisjes në Kryeministri ashtu dhe me IT e AKSHI-t të atashuara pranë institucioneve në vend.


Megjithatë, raportimi i vazhdueshëm është kryer më së shumti në kanale elektronike, duke patur parasysh edhe periudhën e vështirë me të cilën u përballëm që prej marsit të vitit 2020 për shkak të pandemisë së COVID-19.

### *C. Progresi i zbatimit të projekteve në kuadër të secilit Prioritet*

**Plani i Veprimit i Strategjisë së Axhendës Dixhitale** përfshin në total **230 aktivitete** bazë për t'u implementuar deri më vitin 2020.

Nga këto rezulton deri më tani se **156 aktivitete** rezulton se kanë përfunduar dhe **29** e gjithë aktivitetet e planit të veprimit janë në proces. Nga këto aktivitete ka edhe **45** të cilat nuk kemi informacion apo janë tjetërsuar apo nuk kanë gjetur fonde investimi.

### **PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË SË AXHENDËS DIXHITALE 230 AKTIVITETE**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË


KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Një informacion i detajuar për aktivitetet dhe procesin e implementimit të tyre gjendet në Aneksin 1. Plani i veprimit i AD është i ndarë në disa prioritete ku

- Prioriteti i parë “Politikat për zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe ofrimit të shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe biznesin”, ka në total **115** aktivitete ndër të cilat **75** janë përfunduar **16** janë në proces, **24** janë pa informacion ose janë tjetërsuar në aktivitete të tjera me emra të ndryshëm.

POLITIKAT PËR ZHVILLIMIN E QEVERISJES  
ELEKTRONIKE DHE OFRIMIT TË  
SHËRBIMEVE PUBLIKE INTERAKTIVE PËR  
QYTETARËT DHE BIZNESIN  
**115 AKTIVITETE**



- Prioriteti i dytë: Politika për zhvillimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët (shëndetësi, arsim, mjedis, bujqësi, turizëm, kulturë, energji, transport etj) ka në total **83** aktivitete ndër të cilat **58** janë realizuar dhe **7** proces **18** janë pa informacion ose projekte të tjetërsuara.

POLITIKA PËR ZHVILLIMIN E  
INFRASTRUKTURËS SË KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE NË TË GJITHË SEKTORËT  
**83 AKTIVITETE**






REPUBLIKA E SHQIPËRISË


KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT



- Prioriteti i tretë “Politika për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Gjeo Hapësinore (NSDI)” ka **32 aktivitete** ndër të cilat **24 janë realizuar** dhe **6 në proces** dhe **2 janë tjetërsuar** ose nuk informacion.

**POLITIKA PËR KRIJIMIN E INFRASTRUKTURËS  
KOMBËTARE TË TË DHËNAVE GJEO  
HAPËSINORE (NSDI)  
32 AKTIVITETE**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Për sa më lart shohim që për prioritetin 1 janë realizuar 65% të aktiviteteve, për prioritetin 2 janë realizuar 70% të aktiviteteve me një rritje prej 5% krahasuar me marsin e vitit 2019, për prioritetin 3 janë realizuar 75% të aktiviteteve me një rritje prej 60% krahasuar me marsin e vitit 2019. Duke marrë në konsideratë nivelin e aktiviteteve të zbatuara lidhur “Politikat për zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe ofrimit të shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe biznesin” si dhe “Politika për zhvillimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët (shëndetësi, arsim, mjedis, bujqësi, turizëm, kulturë, energji, transport etj)” kanë rezultuar më të prekshme në arritjen e objektivave se sa prioriteti i tretë.

Në mënyrë të përmbledhur zhvillimet e deritanishme përfshijnë:

**Prioriteti I: Politika për zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe ofrimi i shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset.**

Objektivat e prioritetit fokusoheshin në:

*Shtimi dhe promovimi i shërbimeve elektronike, e-shërbimeve, për qytetarët dhe biznesin me 350 shërbime online. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike sipas parimeve të iniciativës “Open Government Partnership”; Zbatimi i një sistemi transparent e gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis*

*Inovacioni kundër korrupsionit - Qendra me Një Ndalesë.*

*Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për e-qeverisjen dhe shoqërinë e informacionit.*

- Zhvillimi i Qeverisjes Elektronike (e-Qeverisja) në pushtetin qendror dhe vendor, me qëllim rritjen me 5 vende të indeksit të e-qeverisjes*

Për realizimin e objektivave të Prioritetit të Parë Startegjik, institucionet e përfshira në realizimin e Planit të Veprimit raportojnë si më poshtë vijon:

**Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit** - AKSHI, ka rritur numrin e shërbimeve elektronike të ofruara Online me impakt në 1,781,700 përdorues ku përfshihen qytetarë, biznese dhe punonjës të administratës publike.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Deri në 31 Dhjetor të vitit 2020 portali ka të regjistruar 1,781,700 përdorues në total, shifer 35 herë më e lartë krahasuar me vitin 2013. Gjithashtu, koordinim dhe ndërlidhje e Bazave të të Dhënave Shtetërore për 55 Institucione.

Në Grafikon 5 vërehet qartë rritje e numrit të transaksioneve të kryera në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, ku gjatë vitit 2020 janë kryer 144,326,634 transaksione . mbi 2 here me shume se viti 2019 ku janë kryer në total 70,224,089 transaksione.




Grafik 5: Numrit i transaksioneve të kryera në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit 2017, 2018, 2019,2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT



*Grafik 6: Ecuria e lidhjes së institucioneve në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit*

Në vijim, ecuria e lidhjes së institucioneve në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit.

Numri i institucioneve të lidhura në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit në vitin 2020 është 9 herë më i madh se ai në vitin 2013, pra 55 institucione të lidhura. Platforma qeveritare e ndërveprimit është një platformë kyçe e realizimit të ndërveprimit të sistemeve të institucioneve në Administratën Publike. Nëpërmjet ndërveprimit të të gjitha bazave të të dhënave shtetërore dhe ndërfaqësimit unik të tyre në një platformë të vetme, ofrohen shërbime elektronike në kohë reale, pa pasur nevojë që për të dhënat dytësore të kërkuara nga një shërbim, të drejtohesh pranë zyrave të ndryshme të administratës publike.

Shpërndarja online e Kartës së Shëndetit për qytetarët shqiptarë e cila ka nisur prej 15 shkurtit 2016, nëpërmjet portalit e-Albania, një risi kjo e cila bën të mundur një ndër hapat për modernizimin e shërbimit shëndetësor si dhe mundësinë e informimit mbi të dhënat e barnave mjekësore të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe çmimeve të tyre.


Në vijim paraqiten të dhëna mbi regjistrimet në portalin unik qeveritar e-Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT



**Grafik 7** Numri i përdoruesve të rinj, 2013 – 2020

Numri total i të regjistruarve në portalin e-albania deri në muajin Dhjetor 2020 është 1,781,700 përdorues përdorues të regjistruar.

Që prej zhvillimit të shërbimeve me vule elektronike deri ne Dhjetor 2020, shifrat e përdorimit janë si në vijim: ( moduli+portali)

- 848,367 gjenerime nga biznesi te Vërtetimeve Tatimore;
- 549,601 gjenerime të Vertetimeve të Mjetit;
- 6,374,424 gjenerime të certifikatave të Gjendjes Civile;
- 173,673 gjenerime të ekstrakteve të nënshkuara elektronikisht;
- 1,348,676 gjenerime të Kartës së Shëndetit;

Disa prej shërbimeve më të përdorura që kryhen tërësisht online kanë shifrat e përdorimit si në vijim:

- 15,000 depozitime të pasqyrave financiare dhe raporteve të auditit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për vitin 2019 dhe 21,983 aplikime për vitin 2020.
- 16,900 aplikime për e-Leje për vitin 2019, dhe 18000 aplikime për vitin 2020

Gjithashtu një risi tjetër përgjatë tremujorit të fundit të vitit 2015 është edhe publikimi në Google Play dhe App Store i versionit më të fundit të aplikacionit mobile për pajisjet Android dhe iOS i cili erdhi me:

- Një pamje tërësisht të re, të ndërtuar mbi teknologji Android dhe iOS;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

## AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT


- Lehtësi më të madhe në përdorim, falë organizimit të shërbimeve sipas tipologjive dhe kategorive përkatëse;
- Lehtësi në autentifikim që në faqen e parë të tij dhe ruajtjen e kredencialeve për një periudhë të caktuar kohe në mënyrë që përdoruesi të mos e kryejë nga fillimi procesin e logimit kur e mbyll dhe e rihap më vonë aplikacionin;
- Lehtësi në shpërndarjen e shërbimeve, lajmeve dhe çdo informacioni tjetër me miqtë përmes rrjeteve sociale, postës elektronike, aplikacioneve të mesazheve

### Të dhënat krahasuese me rajonin për TIK

Në grafikun më poshtë, jepet krahasimi me vendet e rajonit mbi zhvillimin për qeverisjen elektronike sipas të dhënave në raportin e UN për vitin 2020<sup>[1]</sup>. Shqipëria është më mirë se vendet e tjera në rajon (Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut), teksa me diferencë të ulët Serbia qëndron e para, për treguesin për shërbimet online.

- **Për vitin 2020 vendi ynë renditet i 59-ti në botë**, duke ngjitur 15 pozicione në nivel botëror për treguesin e përgjithshëm të e-Qeverisjes krahasuar me vitin 2018 kur është publikuar raporti i fundit. Konkretisht, treguesi është permiresuar nga 0.6519 pike në vitin 2018, në 0.7399 në vitin 2020 (*vlera më e lartë me të cilën mund të vlerësohet një shtet është 1*).

### Treguesi për zhvillimin e qeverisë elektronike



*Burimi: Bazuar në të dhënat e raportit UN e-government survey 2020*

<sup>[1]</sup> <https://publicadministration.un.org/egovkb/en-us/Reports/UN-E-Government-Survey-2018>. Ne raportin e UN nuk ka të dhëna për Kosovën prandaj dhe nuk është paraqitur në grafik;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Treguesi EGDI (E- Government Development Index) llogaritet mbi bazën e tre nëntreguesve:

- OSI - Indeksi i shërbimeve online;
- TII - Indeksi i Infrastrukturës Telekomunikacion;
- HCI - Indeksi për Kapitalin Njerëzor;

Për shërbimet online, Shqipëria është përmirësuar nga vendi i 62-të në vitin 2018, në vend të 31-të në vitin 2020, me pike të barabarta me Kanadanë, Kuvajtin dhe Uruajin. Për e-Pjesëmarrjen vendi ynë ka kaluar nga vendi i 61-te në vitin 2018, në vend të 36-të në vitin 2020 me pikë të barabarta me Spanjën, duke lënë pas në Evropë vende si Italia, Greqia, Portugalia, Gjermania dhe të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor

	2012	2014	2016	2018	2020
Treguesi i përgjithshëm i e-Qeverisjes	86	84	82	74	59
Sherbimet online	92	73	69	62	31
e-Pjesëmarrja	101	59	55	61	36
Infrastruktura TIK	81	90	95	88	94

- Sa i përket nëntreguesit të infrastrukturës TIK (Telecommunication Infrastructure Index), ai përbëhet nga komponentët e mëposhtëm, ku Shqipëria shihet të ketë përparuar ndjeshëm, por duhet shumë punë përsa i përket Fixed Broadband:

	Telecommunication Infrastructure Index	Mobile celular telephone subscriptions per 100 inhabitants	Percentage of Individuals using the Internet	Fixed (wired) broadband subscriptions per 100 inhabitants	Active mobilebroadband subscriptions per 100 inhabitants
Shqipëria, raporti 2020	0.5785	94.18	71.85	12.56	62.79

Vlen të përmendet se Organizata për Bashkepunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) raporti “Government at a Glance: Western Balkans”, i cili fokusohet në qeverisjen publike duke përfshirë fusha si financat dhe ekonomia, punësimi në sektorin publik, institucionet, praktikat dhe procedurat e buxhetit, menaxhimi i burimeve njerëzore, prokurimet publike, qeverisja digjitale, rezultatet e qeverisjes dhe shërbimet ndaj qytetarëve, e ka vlerësuar me nota shumë positive Shqipërinë sa i përket qeverisjes digjitale. Sa i përket Qeverisjes Digjitale, Shqipëria renditet më e vlerësuar nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, duke plotësuar pozitivisht numrin më të madh të treguesve.

Shqipëria është vlerësuar për “**Ekzistencën e strategjive kombëtare të qeverisjes digjitale**”, për zhvillimin e një “**Organi/mekanizmi zyrtar koordinimi, përgjegjës për projektet qeveritare IT në nivel qendror**”, “**Praninë e një politike**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

***gjithëpërfshirëse të të dhënave të sektorit publik***”, ***“Ndërveprimin e të gjithë të dhënave elektronike ndërmjet institucioneve të sektorit publik”*** dhe përmbushjen e ***“Detyrimit të parimit "Open by default" për të dhënat qeveritare”***.

Sa i përket ***“Listës së shërbimeve publike elektronike e publikuar online”***, ky ishte një tregues, që nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor plotësohej vetëm nga Shqipëria, dhe gjithashtu për ***“Ndërveprimin i të gjithë të dhënave elektronike ndërmjet institucioneve të sektorit publik”*** – evidentohet rasti i Shqipërisë, e cila ka integruar sistemet backend të institucioneve publike duke i bërë ato të ndërveprojnë dhe shkëmbejnë të dhëna në kohë reale, në mënyrë të sigurt.

- Gjithashtu, në raportin vjetor të Departamentit të Shtetit për Shqipërinë, zyrtarët amerikanë theksojnë se e-Albania është një përparim domethënës i qeverisë shqiptare në punën e saj për revolucionin digjital.

Sipas raportit të DASH, kalimi i shërbimeve online përmes e-Albania rrit ndjeshëm shërbimin ndaj qytetarëve pasi shmanget kontakti fizik me zyrtarët dhe goditet korrupsioni.

Raporti vlerëson se aktualisht qytetarët shqiptarë marrin 61 % të shërbimeve publike online, ose 15 % më shumë sesa vitin e kaluar ndërsa pritet që Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) të kalojë 91 % të të gjitha shërbimeve publike online në një kohë të shpejtë.

Sa i përket ***(a) Prioriteti II: Politika për zhvillimin e infrastrukturës TIK dhe komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët (shëndetësi, arsim, mjedis, turizëm, kulturë, energji, transport etj);***

***Objektivat e planifikuara në kuadër të Prioritetit të II synojnë:***

- Infrastrukturë e përparuar e komunikimeve elektronike dhe sigurim i spektrit të mjaftueshëm për zhvillimet e infrastrukturës Broadband (NGN/LTE/5G etj), me qëllim mbulimin me shërbim të të gjithë territorit dhe 90% të popullsisë deri në vitin 2020. Ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin etikës në ofrimin e shërbimeve publike.
- Përmirësimi i infrastrukturës TIK në administratën publike për zhvillime të harmonizuara dhe integruara sipas standardeve ndërkombëtare për e-qeverisjen në të gjithë sektorët (shëndetësi, arsim, mjedis, bujqësi, turizëm, kulturë, energji, transport etj) me qëllim ndërlikohen 100% të të gjitha sistemeve deri në fund të 2020.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

- Dixhitalizimi i sistemit arsimor për të rritur cilësinë e arsimit dhe kontribuar në krijimin e një shoqëri bazuar në dije nëpërmjet rritjes së aksesit në kurrikula dixhitale dhe mundësimin të lidhjes të tyre në internet (100%)
- Përmirësimi i infrastrukturës dixhitale në sektorin e Shëndetësisë me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve mjekësore nëpërmjet rritjes me 30% të e-shërbimeve
- Zhvillimi i Inovacionit dhe TIK për Bizneset e Vogla dhe të Mesme duke rritur me 50% numrin e bizneseve që përdorin TIK dhe duke shtuar me 10% numrin e bizneseve në TIK.
- Rrjete e Sisteme informacioni të sigurtë.
- Minimizimi i dallimeve dixhitale midis rajoneve dhe qyteteve nëpërmjet rritjes së aksesit të internetit në 70% dhe përmirësimin të cilësisë së jetesës në nivelin 30%.

dhe (b) **Prioriteti III: Krijimi i Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI);**

**Objektivat e parashikuara brenda këtij prioriteti synojnë:**

- Bashkërendimi ndërinstitucional për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin i të dhënave gjeohapësinore si IMPUT për NSDI.
- Krijimi i një rrjeti unifikues gjeodezik për informacionin hartografik shqiptar duke përdorur rrjetin gjeodezik kombëtar shqiptar.
- Krijimi i një Sistemi të integruar gjeoinformacioni në Shqipëri sipas direktivës INSPIRE dhe përdorimi nga institucionet shtetërore dhe publiku i gjerë.
- Ndërtimi i Sistemit Kombëtar Gjeografik të Informacionit.

të gjitha institucionet e përfshira në strategjinë e përbushjes së aktiviteteve të dakordësuara për Axhendën Dixhitale, kanë qenë pjesë integrale e saj dhe kanë patur ecuri të kënaqshme në përbushjen e aktiviteteve të pasqyruara edhe në matricën e raportit të plotë mars 2019 – dhjetor 2020.

**D. Konkluzione dhe rekomandime**

Në përfundim të analizës së monitorimit të Strategjisë Axhenda Dixhitale 2015-2020 nxjerrim këto konkluzione dhe rekomandime.

Ecuria e implementimit të Planit të Veprimit 2015-2019 për periudhën janar-mars 2019 është në vija të përgjithshme e realizuar 68%, ndër të cilat 230 aktivitete në total janë realizuar 156 projekte dhe në proces janë 29 projekte. Përqindja e realizimit vjen si shkak dhe i tjetërsimit të rreth 45 projekteve prej të cilave kemi informacion se janë ndryshuar dhe inkorporuar në të tjera projekte si dhe një pjesë e vogël e tyre nuk ka gjetur zbatim për arsye financiare apo të ndryshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

## AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

- Progres i mirë është arritur në lidhje me rishikimin e legjislacionit si dhe plotësimet me aktet nënligjore apo dokumentat e politikës, rregullatore etj, në të tre prioritetet strategjike.
- Progres tjetër i rëndësishëm është dhe shtimi i mjaft shërbimeve elektronike dhe përmirësimi i infrastrukturës dixhitale të institucioneve në vend.

Në dhjetor 2020 u miratua Projektvendimi “Për miratimin e planit të veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale “Axhenda Dixhitale të Shqipërisë” 2019-2022. që ka për qëllim rishikimin e planit të veprimit, përditësimin dhe zbatimin e tij për periudhën deri në vitin 2022, duke synuar përditësimin e aktiviteteve dhe shtimin e aktiviteteve të reja për objektivat dhe nënobjektivat e Axhendës Dixhitale bazuar në gjetjet dhe vlerësimin e arritjes së objektivave aktualë. Gjithashtu, projektvendimi synon shtrirjen e periudhës kohore të zbatimit të planit të veprimit aktual, konkretisht deri në vitin 2022.

### **Në problematikat e hasura gjatë fazës së parë të implementimit kemi:**

- a) ***Mungesa e raportimit lidhur me çështjet e mundshme problematike që lidhen me zbatimin e aktiviteteve.*** Edhe pse mund të ketë problematika në zbatimin e aktiviteteve, si përshembull mungesë e fondeve, kapaciteteve të burimeve njerëzore, vonesa për shkak të procedurave të prokurimit, raportimet nga institucionet bëhen vetëm kur u kërkohet. Funkcionimi i grupit tematik të dixhitalizimit dhe e-qeverisjes, së fundmi po shërben si një mekanizëm i mirë për të evidentuar problematikat dhe dhënë zgjidhje vështirësive.

### **Rekomandime për fazat në vijim:**

Për të realizuar me sukses implementimin e Strategjisë Axhenda dixhitale është e nevojshme

- Të vijoje puna për hartimin e axhendes së re dixhitale 2021-2025 dhe hartimin e planit të veprimit perkates;
- Plani i ri i veprimit do mbajë në konsideratë ecurinë e mëparshme, problematikat dhe tendencën e zhvillimit të sektorëve;
- Të mundësohet një koordinim më i mirë me kontributet nga të gjithë insitucionet;
- Të nxitet rritja e përdorimit të e-shërbimeve/zhvillimi i instrumenteve përkatëse nxitëse.